Vdekje fashizmit — Liri Popullit

Poštarina plaćena u gotovu
Taksa postale e paguerne

RILINDJA

ORGAN I FRONTIT POPULLUER TE KOSOVES E METOHIS

ИЗЛАЗИ ДВА ПУТА НЕДЕЉНО, ЧЕТВРТКОМ И НЕДЕЉОМ

DEL DY HERE NE JAVE: E ENJTEN DHE TE DIELLEN

Redaksija: Prishtine
Rruga Emin Duraku Nr. 1

PAJTIMET
per 1 vit 192 din
— 6 muej 96 —
— 3 muej 48 —

Dorshkrimet nuk kthehen

Odgovorni urednik XHELADIN HANA
Drejtori pergjegjes

Vjeti IV Nr. 124 | PRISHTINE, e ejte 15 Korrik 1948 | Çmimi 2 dinarë

Edhe nji fitore e re pune

Me shtatë Korrik u-inaugurue hekurudha e re Prishtinë-Kurshumli

Populli i Prishtines e festoi Shtate Korrikun —Diten e kryengritjes popullore te Serbis, edhe me nji fitore te re pune te popujve t'one. Ne kete dite u inagurue hekurudha e re Prishtine—Kurshumli.

Ne qytet, ke stacjoni, u mbajt nji miting i madh. Shqiptare, serb e malazez shprehen besnikin dhe dashunin e tyne ndaj Partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokut Tito. Ky unaminitet qe pergjegja ma e mire e popullit dhanun shpifjeve te drejtueme kundra Partis dhe Vendit t'one.

Me trenin e pare nga Kurshumlija mbrriten ministri i komunikacjonit te Qeveris Qendrore — Todor Vujasinoviq, Ministri i Industris R. P. te Serbis — Voja Lekoviq dhe ministri i minjerave te Republikes Popullore te Serbis — Mehmet Hoxha. Perveç nji mnrije punetoresh nepunsash dhe qytetaresh kishin dale me prite trenin e pare edhe antaret e Komitetit Krahinuer dhe Komitetit te Vendit te PKJ.

Ne mes te pershendetjeve te zjarrta te turmes prezente shoku Todor Vujasinoviq, nder te tjera tha:

„Kur ka fillue ndertimi i kesaj hekurudhe ne kohen e Jugosllavis se vjeter, nuk ka pase njeri qe te kete mujte me thane se kur do te perfundohet. Sundimtaret e vjeter dhe kapitalistat, kishin per qellim vetem profite e jo interesin e popullit.

Kur na kemi pase fillue ndertimit te kesaj hekurudhe, na kemi thane se do t'a kryejme me Shtate korrik 1948. S'ka pase njeri qe nuk ka besue se do te kryhet. Kjo rrjedh nga fakti se ne Jugosllavin e re jane krijue njerez te ri, te ndergjegjeshem se Jugosllavija e re asht atdheu i Vendit puntuer, te cilin e udheqe Partija Komuniste e Jugosllavis, Komiteti Qendruer dhe shoku Tito prej fitoreve ne fitore (duartrokitja te vazhdueshme per Komitetin Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokun Tito).

Kjo hekurudhe asht nji nga detyret e shumta te parapame me Planin t'one pesvjeçar. Me anen e kesaj e kemi lidhe edhe me nji vi hekurudhore, vllaznimi Kosmetin me Serbin, popullin shqiptare me popullin Serb. Por, para nesh qendrojne edhe shum detyre te tjera te lidhuna me plotsimin e Planit pesvjeçar. Keto detyre jane te randa, por na nuk trembemi prej veshtirsive, sepse nuk u jemi trembe as me 7 korrik 1941, kur e kemi fillue luften kundra okupatorit fashist. Jemi mesue me u ba balle veshtirsinave dhe nen udheheqjen e shokut Tito do t'a vazhdojme rrugen ne te cilen asht tue na pri, per ndertimin sa ma te shpejte socjalist t'atdheut t'one.

Tue fole mbi shpifjet qe na jane ba me rezolucjonin e byros Informative shoku Vujasinoviq tha:

— Ne keto ditet e fundit na ka ngja diçka qe nuk e kemi prite. Por tue e marre per baze gjithshka asht ba deri tash ne Vendin t'one nuk ka njeri qe te mos i bjedhe poshte me perbuzje shpifjet qe na jane ba.

Na thone se n'udheheqesin t'one ka njerez qe nuk e duen Armaten e Kuqe dhe Bashkimin Sovjetik. Na, nga dashunija ndaj BRSS dhe nga dashunija ndaj atdheut t'one e kemi fillue luften me 7 korrik 1941 me duer thate kundra kulçedres fashiste. Na atehere kemi dijte me e dashte Bashkimin Sovjetik, atehere kur dashnija ndaj Bashkimit Sovjetik paguhej me gjak, dhe gjithmone kemi luftue n'emen e Bashkimit Sovjetik.

Per kete arsye na edhe tash nga ky vend, u a themi elementave reakcjonare: Vendi i jone asht ne komunitetin ma demokratik me Bashkimin Sovjetik ne krye. (Brohoritje te vazhdueshme „Tito — Stalin", „Beograd — Moske".) E per kete, na duhet me i forcue edhe ma teper rradhet t'ona rreth Komitetit Qendruer dhe shokut Tito, duhet t'i dyfishojme perpjekjet t'ona per plotesimin e Planit pesvjeçar. (Brohoritje per krijuesin e Planit pesvjeçar, shokun Tito, per Komitetin Qendruer).

Ministri i industris se Republikes Popullore te Serbis, Voja Lekoviq i pershendeti qytetaret e Prishtines n'emen te Qeveris Popullore te Serbis, tue thane ne mes te tjerash:

Si sot shtate vjete me 7 korrik 1941 ka krise pushka e pare shlirimtare ne Vendin t'one. Kjo ka qene thirrja e Partis Komuniste te Jugosllavis ne lufte per liri, pamvarsi e jeten ma te lumtun per popullin t'one puntor. Popujt t'one ju pergjegjen kesaj thirrje dhe nen udheheqjen e Partis, luftuen heroikisht deri ne fitore. Partija e jone e kreu me ndere detyren e vet. U-ndertue Republika Federative Popullore e Jugosllavis.

Mandej shoku Lekoviq tue fole mbi luften e Partis ne periudhen e rindertimit dhe ndertimit socjalist, tha:

—Kjo hekurudhe me gjithe se asht e gjate 70 km. asht vetem nji pjese e vogel e Planit t'one pesvjeçar. Une besoj se nen kushtet e Jugosllavis se vjeter kjo hekurudhe ç'prej atehere e deri sot ende nuk do t'ishte gati. E na ç'prej shlirimit e kendej kemi shtrue 800 km. hekurudha te reja. Te gjitha keto i konsiderojme, prap si pjese te Planit pesvjeçar qe ka per qellim, qe ka mi i zgjidhe te gjitha çashtjet kryesore te ndertimit t'one socjalist.

Na jemi te bindun se do t'a realizojme Planin t'one, sepse e dijme qe njerzit te cilet e udheheqin luften per plan jane ata qe na kane udheheqe prej fitoreve ne fitore gjate kohes se luftes. Ne Vendin t'one jo vetem qe shtohet prodhimi industrijal, i cili asht shum ma i madh se ne vjetin 1939, porse prodhohen artikuj, maqina te reja, te cilat ma pare i blejshim nga jashte.

Keto dhe suksesat tjera i dijne si miqet ashtu edhe anmiqet e Vendit t'one. I dine miqet t'one, por nuk i shiqojne te gjithe njisoj. Per ne tash flasin ndryshej, bile edhe disa prej tyne qe kane ardhe e marre mesim prej nesh. Thone se na jemi ndryshue. Ata tash kane ndryshue dhe thone se ne Jugosllavi nuk punohet si duhet. Por per se shpejti do te binden se njerzit t'one nuk ndryshojne aq lehte. Ata sot na fyejne, i fyejne popujt t'one, Republiken t'one Federative Popullore te Jugosllavis, Komitetin t'one Qendruer dhe shokun Tito (Brohoritje te vazhdueshme: Tito—Partija; Na jemi te Titos, - Tito asht i joni!). Kjo i fyen jo vetem antaret e Partis, por edhe te gjithe qytetaret e ndershem te RFPJ. Prandaj i hedhim poshte akuzat e tyne si shpifje, sepse nuk mund te lejojme qe te mshehet e vertela qe t'errsohet ajo qe asht e shkelqyeshme (Brohoritje per Komitetin Qendruer dhe shokun Tito).

Ata thone se si gjoja na ndjekim politike te jashtme kundra Bashkimit Sovjetik (Thirrje: Beograd — Moske, Tito—Stalin). Ata marrin guximin me thane se popujt t'one jane kunder Bashkimit Sovjetik, e na u-pergjigjemi me fjalen e vjeter popullore: ari ne zjarm provohet, miku ne rrezik kuptohet.

Po i pyesim: kur ishte ma se veshtiri me qene mik i Bashkimit Sovjetik kush e ka deshte Bashkimin Sovjetik ma forte,-na apo te tjeret? (Brohoritje Tito—Stalin). Bashkimi Sovjetik nuk ka mik ma te mire e ma besnik

(Vazhdon ne faqen e trete)

REGJISTRIMI I HUAS POPULLORE

Deri n'ora 18 te dates 13 korrik jane regjistrue ne Krahinen t'one 115.460.000 dinare

1) Rrethi i Mitrovices	12.369.000 din.
2) Rrethi i Gjakoves	11.707.000 „
3) Rrethi i Rahovecit	8.526.000 „
4) Rrethi i Pejes	8.348.000 „
5) Rrethi i Ferizajt	8.230.000 „
6) Qyteti i Prishtines	7.823.000 „
7) Rrethi i Liplanit	7.042.000 „
8) Rrethi i Gjurakovcit	5.834.000 „
9) Rrethi i Gilanit	5.321.000 „
10) Qyteti i Mitrovices	5.105.000 „
11) Rrethi i Serbices	4.998.000 „
12) Qyteti i Prizrenit	4.360.000 „
13) Qyteti i Pejes	4.136.000 „
14) Rrethi i Prishtines	3.940.000 „
15) Rrethi i Vuçiternes	3.708.000 „
16) Rrethi i Suharekes	3.771.000 „
17) Rrethi i Prizrenit	3.108.000 „
18) Rrethi i Podujeres	2.968.000 „
19) Rrethi i Kamenices	2.523.000 „
20) Rrethi i Dragashit	1.943.000 „

Nga shuma e siperme e regjistrueme per Huan popullore bujqit kane regjistrue 55.189.000 dinare, puntoret: 13.810.000 dinare, nepunesat: 15.558.000 dinare, zejtaret: 2.482.000 dinare, Rinija: 17.644.000 dinare dhe profesjonet tjera: 10.777.000 dinare.

Rezultatet ma te dobta jane mbrrijte ne rrethin e Prishtines, Vuçiternes, Podujeves dhe te Kamenices. Ne keto rrethe nuk asht ba agjitacjoni i mjaftueshem dhe nuk asht skjarue e vue ne dukje aq sa duhet randesija e regjistrimit te Huas popullore. Gjithashtu nga keto rrethe as lajmet nuk mbrrijne ne rregull.

Duhet me ba ç'mos per realizimin e planit te kontraktimit te drithnave

Puna per kontraktimin e drithnave te bardhe do te vazhdoje deri ne fillimin e blemjes se detyrueshme te ketyne drithnave, dmth. deri me 25 ketij muajit. Tue qene se kontraktimi asht nji mase e randesishme e pushtetit popullor per sigurimin e fondit te drithit nga nji ane, dhe per furnizimin e permiresimin e standardit jetesuer te katundaris s'one punuese, n'anen tjeter, asht koha e fundit qe t'i angazhojme te gjitha forcat per realizimin e planit te parapame.

Nga rezultatet e deritashme konstatohet se vetem ne rrethin e Pejes asht realizue plani i kontraktimit dhe bile asht tejkalue me 27 per qind, kurse perqindja e realizimit te planit ne rrethet tjera kapet prej 47-91 per qind. Ma se dobti qindrojne keto rrethe: Kamenica, Podrimja, Lipjani, Gilani, Prishtina, Podujeva, Suhareka e Prizreni. Plani i pergjitheshem i kontraktimit asht realizue deri tash vetem me 64 per qind.

Nji mossukses i ketille asht shkaktue, ne rend te pare, nga vigjilanca e pamjaftueshme e organeve te grumbullimit dhe te kooperativave, nga moskuptimi i randesis se kontraktimit, nga mos-shjarimi i mjaftueshem i dispozitave te Dekretit, nga puna e dobet e agjitatorve dhe e organizatave masovike, nga lufta e pamjaftueshme kunder elementave anmiqe, te cilet jane perpjeke ne çdo menyre me e pengue realizimin e planit, nga gabimet n'interpretimin e Dekretit etj. Ne Rogove asht interpretue keq dispozita e Dekretit ne lidhje me livadhet, ku asht thane se gjoja keto konsiderohen si ara te mbjelluna, kurse ato, ne baze te Dekretit, ndikojne ne kategorizimin e ekonomis shtepijake dhe ne perqindjet e dorezimit te tepricave te drithit simbas gjendjes reale te frytit. Ne rrethin e Prishtines ka ngja qe te mos pranohet kontraktimi per se dyti i atyne ekonomive shtepijake, te cilat e kane çmue randesin e kontraktimit dhe kane dashte me i shtue sasinat e kontraktueme ma pare. Ky asht nji nder gabimet e mdhaja. Nji ekonomi shtepijake qe ka kontraktue ma pare ndonji sasi drithi, mundet me kontraktue edhe ma — pamvarsisht nga kontraktimi i maparshem, por me ket rast organet e lidhjes se kontratave duhet te kujdesohen qe shuma e pergjitheshme e sasinave te kontraktueme te mos e kaperceje maksimumin prej 6500 kgr.

Nga rezultatet e deritashme asht konstatue edhe nji gja se kontraktimin e kane ba ma teper ekonominat e vogla dhe te mesme shtepijake, kurse ekonominat e mdhaja-shtepijat ma pasanike te katundeve — kane kontraktue ma pak. Ka pase raste qi disa pasanike katundesh e kane kundershtue haptazi kontraktimin, disa sish jane perpjeke mos me i lane te tjeret me kontraktue, e disa pasanike kane kontraktue vet dhe kane tentue me gjete edhe persona tjere qe te kontraktojne n'emen te ketyne qe te grumbullojne sa ma teper malina industrijale me qellim spekulimi. Nga kjo shihen qellimet e damshme dhe spekuluese te ketyne fare elementave nga rradhet e pasanikve te katundit. Keta elementa duhet te demaskohen dhe te tregohen me gisht ne çdo konference, e ne rast nevoje te merren edhe masa ligjore kundra tyne.

Nder shumicen e rretheve nuk i asht kushtue kujdes i duhun punes agjituese qe te kontraktojne edhe ekonominat pasuna te katundeve, e disa drejtorina te grumbullimit kane shkue larg, sa kane mendue se gjoja keto ekonomina nuk duhet te kontraktojne dhe me qellim i kane lane me kontraktue pak, ne menyre qe te mos i çfrytezojne te mirat e Dekretit, e prandaj as nuk kane ba ndonji perpjekje; per t'i binde me kontraktue. Edhe kjo asht nji e mete qe duhet te zhduket sa ma pare, mbassi nga suksesi i kontraktimit mvaret sigurimi i fondit t'on e te drithit, perforcohet sektori socjalist i ekonomis s'one dhe shpejtohet procesi i ndertimit te socjalizmit ke na. Prandaj lufta per plotesimin e planit te kontraktimit asht lufte per socjalizem, sepse mosrealizimi i ketij plani pengon realizimin e planeve t'ona n'industri dhe ne deget tjera t'ekonomis s'one me plan.

Per realizimin e planit te kontraktimit duhet t'i mobilizojme te gjitha fuqit dhe, tue marre para syshe kohen e shkurte, te bajme çmos qe plani te plotesohe para se me fillue blemja e detyrueshme e drithnave.

Tue qene se nga dita e sodit fillon edhe kontraktimi i misrit, duhet te merren masat e nevojshme per çdukjen e te gjitha te mbetave te konstatueme deri tash dhe te bahet nji lufte e madhe si per plotesimin e planit te kontraktimit te drithnave te bardhe ashtu edhe te misrit, mbassi kjo asht si n'interesin e shtetit t'one popullor ashtu edhe n'interesin e vet prodhuesave t'one. Puna agjituese duhet te jete shum ma e gjalle jo vetem per kontraktimin e tepricave te detyrueshme por edhe i tepricave te lira. Organet e grumbullimit duhet te jene gjithnji ne lidhje te ngushte me organet e pushtetit popullor te vendit e me organizatat e Frontit ne menyre qe te mos u mungoje ndihma e tyne.

H. H.

Ne te gjitha viset e Krahines s'one antaret e Partis bashkohen edhe ma fort rreth KQ te PKJ dhe shokut Tito

GJURAKOVC

Ne krahinen t'one, antaret e Partis Komuniste gjithnji e ma teper bashkohen rreth Komitetit Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis dhe shokut Tito. Ne fushaten shpifse kundra Partis s'one ata pergjigjen me deklaratat e solidarsis dhe besnikis ndaj Komitetit Qendruer dhe shokut Tito.

Keshtu, delegatet e konferences se rethit te Partis te rethit t'Istokut, mbasi zgjodhen delegatet per Kongresin e Peste te P.K.J. i derguen nji telegram pershendetes K Q te P.K.J., ne te cilin ne mes te tjerash thuhet:

"Komiteti i yne Qendruer dhe shoku Tito na kane mesue se si duhet me luftue kundra okupatorit dhe trathtarve te vendit, e per krijimin e pushtetit te popullit punues. Shoku Tito na ka mesue se si duhet te krijojme vllaznimin dhe bashkimin ndermjet shqiptareve, serbve dhe malazezezve, ai na ka mesue si duhet te luftojme per permiresimin e kushteve jetesore te njerzeve punuesa e si te luftojme kundra spekullantave e kullakve. Ai na ka mesue dhe na ka frymezue me dashni te pa kufishme ndaj Bashkimit Sovjetik dhe shokut Stalin. Tito na ka mesue si duhet te zhvillojme ne Partin t'one demokratizmin, t'a ruejme kritiken dhe autokritiken, si armen ma te forte ne duert e komunistave. Keshtu, na jemi ba te forte dhe te bashkuem, e kemi fitue meriten dhe besimin e popullit.

Na e kemi prite me çudi te madhe rezolucjonin e byros Informative te partive komuniste, ne te cilen na bahen akuza te randa dhe krejt te palbemelta. Deklarojme se kurrgja s'mund te na ndaje prej Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito, por ma teper do te punojme ne realizimin e linjes se Partis tue u-bashkue edhe ma fort reth Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito."

Velko Vllahoviq

PERGJEGJSIJA E KOMUNISTAVE

Pergjegje shokut Gustav Baresh dhe „Rude pravo-s"

Me rastin e „rezolutes se byros Informatyve te partive komuniste mbi gjendjen ne partin komuniste te Jugosllavis", gazeta e Prages "Rude pravo" e botoi nji artikull te Gustav Bareshit me themen mbi "pergjegjsin e komunistave jugosllav".

Tue e njeftue shkruesin e artikullit qysh prej nji kohe te gjate, nuk mundem me mbete pa e pyte ate edhe si shok i moçem, edhe si mik edhe si komunist: a thue ti, Gustav, si nji nga pjesmarrsat ne konsulten e byros Informative, si nji nga shoket udheheqsa te partis moter çekosllovake, guxone me i lejue vehtes per me trillue gjana te pasakta dhe ne baze t'atyne trillimeve me e ofendue Partin t'one e Vendin t'one? A nuk e mendove ti, kur ja hyne punes per me trajtue problemin e pergjegjsis se komunistave, se sa asht edhe pergjegjsija e jote personale dhe se ne çfare pozite qesharake ke ra, jo vetem para partis s'one e popujve t'one, por edhe para Partis e Vendit tand, kur i perdore trillimet si argumenta dhe u shton atyne trillimeve analizat teorike ne baze te marksizem-lenjinizmit?

E dij se ti e njef mjaft teorin e marksizem-lenjinizmit. Besoj se nuk e ke harrue se si Lenini i ka vue ne loje sofistat te cilet "me anen e manevrave e kalojshin mbrendin e gjanave", por ti kete gja nuk e ke pase para syesh kur me anen e manevrave je perpjekë me e tregue te bardhen si te zeze. I ke hy me te vertete nji puneje shum te palavdishme.

I mushun plot derte per çeshtjen e "pergjegjsis se komunistave jugosllav", ti, me shpifjet t'ua ke marre anen e padrejtesis ma te madhe qe e jetuen ne historin e vet Partija e jone heroike, klasa puntore, turmat punuese, te gjith popujt e Jugosllavis. Kjo padrejtesi asht edhe ma e madhe nga ana e yte sepse e dij se sa fort e ke admirue Partin t'one, luften t'one dhe sa fjale te bukura ke thane me rastin e qendrimit ne Vendin t'one.

Ti pohon se udheheqsija e Partis s'one ne te gjitha çeshtjet themelore te politikes se jashtme "e ndjeke linjen e padrejte e cila nuk ka kurrgja te perbashket me marksizem-lenjinizmin". Kete pohim tandin, i cili ne realitet asht shpifje kundra Republikes Federative Popullore te Jugosllavis dhe politikes se saje te jashteme te vendosun demokratike, nuk e veshe me asnji çeshtje themelore te marredhanjeve nderkombtare ne te cilen udheheqsija e Partis dhe e Shtetit t'one gjoja ka pase „linje te padrejte". Ti ndoshta mendon mbi çeshtjet themelore per te cilat shkruen, ne qendrimin e Jugosllavis kundrejt akcioneve te luftenxitesave, kundrejt planit Marshall problemit te Gjermanis, kundrejt Hungaris e vendeve dhe popujve te tjere demokratike te cilet qene fute nga ana e regjimeve te veta kundra popullo e ne taborrin e satelitve te Hitlerit? Na shprese me te drejte se nuk e mendon ket gja. Po t'a kujtoj vetem nji shembull te vogel, por teper shum karakteristik. Ndersa ti udhtojshe per ne komunikata e byros Informative, reakcioni amerikan e organizoi eliminimin e Njujorkut grevën, tue e pengue ngarkimin e anijes s'one transoqeanike "Radnik", sepse ne kabinen e kapitenit t'anijes ndodheshin fotografit e shokeve Stalin e Tito. Keta dy fotografi me te cilat nuk i çojne vetem anijat t'ona detnet e oqeanet, por ndodhen te skalituna thelle ne zemrat e çdo antari te Partis, te çdo qytetari te nderthem te Vendit t'one, jane simboli i politikes s'one edhe te jashtme edhe te mbrendshme. Prandaj, nuk asht gja e rastit se kete pohim tandin, si edhe te gjitha te tjerat, fundi i fundit, i ke lane pa kurrfare argumentesh. Prandaj, ato shka ti ke shkrue mbi politiken e jashtme te udheheqsis s'one te Partis e te Shtetit, nuk mund te quhet ndryshej veçse shpifje qellim keqe, sepse nuk ke as edhe nji argument te vetem, nga shka ka i thjeshte se kso argumentash nuk ka.

Tue u mbeshtete ne konkluzat e rezolutes se byros Informative ne çeshtjen "e pikepamjes se pergjithshme t'udheheqsis se PKJ ndaj Bashkimit Sovjetik", ti, ne gazeten "Rude pravo", shkruen edhe kete: "asht konstatue se . . . rrolin udheheqes te levizjes revolucionare nderkombetare me te drejte duhet t'a merrte Jugosllavija". Dhe mandej ti shton: "Ne Jugosllavi gjoja kane zbulue forma te reja t'organizimit shtetnuer dhe te jetes publike ma te perfeksionueme se sa ne BRSS — siç ka shkrue mbi kete para pak kohe nji nga njerzit udheheqsa te PKJ". Po te pyes para antarve te Partija Komuniste te Çekosllovakis, ne faqe te mbare opinjonit Jugosllav: Kush, ku dhe kur asht pohue ne Partin t'one dhe ne mbare Vendin t'one se „rolin udheheqes te levizjes revolucjonare nderkombetare me te drejte duhej t'a merrte Jugosllavija?" Po te pyes: Si e ka emnin „njai nji nga njerzit udheheqesa te PKJ" i cili ka shkrue se ne Jugosllavi jane zbulue „forma te reja t'organizimit shtetnuer dhe te jetes publike ma te perfeksionueme se ne BRSS", ku asht shkrue e botue kjo, kur "para pak kohe" ka ngja kjo? E dij se keto pyetje do t'i lashe pa pergjegje, sepse mbi to nuk do te mundesh me u pergjegje, se edhe ti vet e din mire se nji gja e ketille ne Jugosllavi kurr se askush, as nuk e ka shkrue e as nuk e ka thane.

Ti shkruen gjithashtu, per Partin t'one dhe udheheqsin e saje se" e ka marre arsenalin shpifjeve kundra Bashkimit Sovjetik nga trockistat dhe armiqet e tjere ma te keq". Tue te dhane pergjegjen ne kete pohim te perçudshem, mue me duhet me te kujtue, se Vendi i yne gjate luftes se dyte botnore që i vetmi vend n'Europen e okupueme ne te cilin ne pjesen ma te madhe te territorit te tij, çdo tentative shpifjeje kundra Bashkimit Sovjetik trajtohesh si krim kundra popujve te Jugosllavis, se nji grusht trockistash, te cilet gjate luftes e treguen surratin e tyne si bashkepuntore dhe agenta t'okupatorit, mbarusen me turp para gjyqeve popullore, se Atdheu i jone qysh ne momentet e para nga çlirimi, që i vetmi vend n'Europe — natyrisht perveç Bashkimit Sovjetik —, ne te cilin nuk ka mujte me dale dhe nuk ka dale asnji gazete me shpifje kundra Bashkimit Sovjetik, se ne te nuk ka mujte me u mbajte dhe nuk asht mbajte asnji mbledhje ne te cilen te jete fole kundra Bashkimit Sovjetik. Perveç Jugosllavis, shenoje te pakten edhe nji vend tjeter n'Europe ku, ne saje te fuqis, besnikeris se pathyeshme ndaj Atdheut te socjalizmit dhe te syçelsis se Partija Komuniste, te jet ba e pamundeshme çdo shpifje kundra Bashkimit Sovjetik. Kerko sa te duesh ne Karten gjeografike t'Europes, e — natyrisht veç emnit te Jugosllavis, — nuk do te jesh ne gjendje me e shquptue asnji emen tjeter. E atehere, ku asht si „arsenat shpifjesh" i perçudshem i cili u hodh, si nji fyemje e paturpshme dhe aq brutale ne faqe te mbare Partis s'one, klases puntore, te gjith popujve te Jugosllavis? A thue e ke harrue ti se na ne Jugosllavi dashtunin dhe besnikrin t'one ndaj Bashkimit Sovjetik, koshjencen t'one mbi rrolin udheheqes dhe shliruar te Bashkimit Sovjetik e kemi tregue jo vetem mbas fitores mbi fashizmin, por edhe atehere kur kjo gja u tregue me sakrificat e viktimat ma te medha te vetedijshme.

Keto shpifje t'uá tregojne se asht e nevojshme me te vertete me u marre me çeshtjen e pergjegjsis se komunistave, dhe ne rend te pare me çeshtjen e pergjegjsis tande personale. Neve nga ana e jone, mund te themi se komunistat jugosllav keto shpifje dhe te tjerat si keto, nuk do t'i shmangin nga rruga qe u a tregoi atyne Partija e vet. Komunistat jugosllav nuk do te pushojne me insistue ne fellimin e mazatjeshem te marredhanjeve miqesore e vllaznore me Republiken Çekosllovake, Partin dhe popullin e saje. Po te pyes se a asht pergjegjsija e jote po me kete shkalle? Kjo pyetje mund te bahet edhe ne lidhje me çeshtjen tjeter mbi te cilen shkruen ti, e kjo asht çeshtja e „shtremnimit te se vertetes para turmave". Kush e shtremnon te verteten? Partija e jone a po ndonji tjeter? Faktet jane t'atilla sa kundra tyne nuk mund te bahet kurrgja. Sado qe ato te heshten dhe te kalohen — faktet mbeten fakte. Shif vetem se ne ç'fare situate qesharake e çojne vehten komunistat çekosllovak, kur shpalli — siç ngjau sot ne „Rude pravo" — se organizata e Partis n'Univerzitetin e Beogradit, te ket çue krye kundra udheheqsis se Partis. Nuk do t'ishte keq qe t'a lexojsh gazeten „Borba" me tre te ketij muaji, ku do t'a gjejsh qendrimin e organizates se Partis ne universitetin e Beogradit, qendrim i cili asht krejtesisht ndryshej nga ai qe shkruen „Rude pravo". Ketu mundem me te thane edhe kete se un vete jam njeni nga delegatet e organizates se partis t'univerzitetit te Beogradit per Kongresin e Peste.

Asht gja shum famekeqe me i falsifikue faktet. Ne nji situate te njajte me gazeten „Rude pravo", ndodhen edhe gazeta e Romes „Unita" dhe ajo e Parisit „Imanite" te cilat u thone lexuesve te tyne se Partija Komuniste e Jugosllavis nuk ka guxue me e shpalle rezoluten e byros Informative. Me gjithse mbar bota e din se organi i Partis „Borba", e ka botue rezoluten, shoku Diklo nuk ka dashte me shkrue ne gazeten „Imanite" sa vijon „fakti se udheheqsat Jugosllav nuk e kan shpalle rezoluten e byros Informative, flet kjartas se nuk jane te sigurte n'argumentime e veta dhe se kane frige me e thane te verteten para popullit". Ne kete linje jane edhe akuzat e tjera te padenja ne gazeten „Imanite" si ajo mbi bashkepunimin e ngushte me imperjalistat amerikan, me te cilin rast theksohet sidomos argumenti mbi arin jugosllav te bllokuem n'Amerike. Mbare bota e din se sa kohe te gjate qe po vazhdon lufta e perfaqsuesve t'one ekonomik e diplomatik mbi çashjen e deblokimit t'arit. Dihet gjithashtu edhe fjalimi i perfaqsuesit sovjetik ne Konferencin ekonomik t'organizates se Kombeve te Bashkuem mbi kete çashtje. Tash bjen me nji here si nga qielli se do t'ishte ma me mend me u a lane imperjalistave amerikan parasin t'one popullore, se sa me e perdore ate ne jehonen e ndertimit te Planit pesvjeçar, per te miren e popujve te Jugosllavis. Llogjike e çuditshme kjo! Per sa i perket qendrimit t'one ndaj imperjalistave, mund te jene te sigurte edhe miqt, edhe armiqet t'one se politika e Jugosllavis, si nji nga fuqit perbase te taborrit sovjeto-demokratik e antiimperjalist nuk do te ndryshoje asnji fije.

Ne lidhje me te gjitha çashtjet rreth „shtremberimit te se vertetes para turmave", nuk duhet te harrojsh, shok Baresh, se deri tash nuk ka ngja qe ne partit komuniste, rrenat te sherbejne si argumenta, si ne politike ashtu edhe ne shkrimin e artikujve kritikues. Kjo asht hera e pare qe nder ne komunistat rrenat perdoren si argumenta.

Prandaj paraqitet gjithnji ma e ashper çeshtja e pergjegjsis se komunistave para partis, klases puntore e popullit te vendit te tyne per te gjitha ato shka shkruen, flasen e bahen.

Po ne kete linje te shpifjeve asht edhe pohimi i yt se ne Jugosllavi „asnji komunist" nuk guxon t'a pohoje hapit antarsin e vet ne Parti", se ke na ne parti ekziston „regjimi dhespotik i cili i qiron besapet ashpersisht me te gjithe ata qe kritikojne" etj. si keto. A thue mundesh me fole keshtu, e mos te te vije turp, mbi njerzit, trupi i te cilve asht ba shoshe nga plumbat fashiste, vllaznit e motrat e te cilve kane vdeke heroikisht per çeshtjen e perbashket te njerzimit progresiv, tue luftue per Partin Komuniste, Bashkimin Sovjetik, Stalinin e Titon? Ne kete menyre ti pohon se Partija e jone heroike — asht parti e qyqarve ,te cilet nuk guxojne me thane se jane komunista dhe se dheta e qinda mija njerzish me „shenjen e kujtimit te vjetit 1941", me shum dekorime, shenjat e bashkimit te luftarve, shenjat e salmuesit, mbledhen mshefttazi dhe dridhen nga frika qe mos t'i diktojne ndokush-se te gjithe keta nuk jane kurrgja tjeter veçse „instrumenta servile", e tjera si keto, kso shpifjesh ashtu u an shok Bareshi kundra avangardes se popujve te Jugosllavis, e cila nen udheheqjen e Komitetit Qendruer me shokun Tito ne krye, u farkue ne qinda beteja t'ashpra kundra armiqve te popujve te Jugosllavis. Un e dij se edhe ti e din mire se ne Partin Komuniste te Jugosllavis nuk jane fute njerez nga skutat e sallonet diskutante, por jane fute njerez nga rradhet e para te luftes per jete ma te mire te popullit punues, nga rreshtet sypuese te brigadave t'ona, nga puna e palodhshme e ndertimit te socjalizmit. Por ti — shok Baresh, i ke harrue keto koshjentisht ne keto momente.

Tue e lexue artikullin tand njeriut i duhet me kujtue se tradhtaret e klases puntore, trockistat e bukarinistat e ndryshem, e shpifshin po me keso fjalesh Partin e bolshevikeve. N'ato shpifje te tyne, shoku Stalin u pergjegji ne vjetin 1923 me keto fjale: „Fjale trashanike dhe te shame n'adresen e Komitetit Qendruer, pa tjeter nuk ka pase pak. „Pravda" ka qene plot me artikuj, te mdhaj e te vegjel, me te cilet akuzohej Komiteti Qendruer per te gjitha mekatet e botes tjeter. Mungon vetem nji gja, e kjo asht se nuk e akuzojne per te,- metin ne Japonin". Keto dite edhe Komitetin Qendruer t'onin, edhe Partin t'one, e akuzojne per te gjitha mkatet e botes tjeter. Te thame dhe fjale trashanike ka per se tepermi. Kryne te thamene ti i ke shtue edhe diça te tuat. Ka mbete vetem qe Partija e jone t'akuzohet per vershimin e ujnave ne Nish dhe rrethet e tij, qe ngjajten ne kohe kur ti ndodheshe ne mbledhjen e byros Informative.

Mbas fyemjeve te keqija te paleje-eshme, si edhe nji serie akuzash te njollosuna, te pathemelta ne lidhje me politiken e mbrendeshme te Partis s'one, me linjen e saje ne ndertimin e socjalizmit, ti — shok Bareshi fton komunistat jugosllav qe sot „duhet te ngjallen". Bashkohesh me thirren, dergue antarve te PKJ, per me e shkatrrue bashkimin e Partis se vet, qe te çohen kundra udheheqsis se saje. I u kujton komunistave jugosllav se „nuk munden me i tradhtue me dheta mij deshmore te cilet ne luften naçjonal çlirimtare i dhane jetnat e veta ne frontin e perbashket me Armaten Sovjetike dhe luftaret komuniste te gjithe vendeve". Bareshi dhe gazeta „Rude pravo" pa tjeter presin pergjegje te kesaj thirrje te tyne shkatrrimtare. Ata munden me marre nga Jugosllavija vetem nji pergjegje: na tashma kemi zgjedhe. Partija e jone e ka zgjedhe Komitetin Qendruer me shokun Tito ne krye, nen udheheqjen e te cilit asht çelnikose, asht ba e kalitet si shkelqimi, shpate e mprefte dhe asht aftesue per me i kpute pranjat e robijns dhe t'i çoje popujt e Jugosllavis ne rrugen e lavdishme ne liri, ne socjalizem. Nga dita ne dit nga pushk'e pare çlirimtare n'Atdheun t'one,ne Frontin t'one jugosllav kundra fashizmit, Titon e kane zgjedhe me dheta e qinda mija luftare, tue votue per te çdo dite, dhe njiqind here ne dite, me kokrren e çelikut ne zemren e nazizit. Komunistat jugosllav u kane mbete besnike heronjve dhe luftarve te rame te Partis s'one, te cilet kane vdeke me emnin e Stalinit dhe Titos ne goje, per Jugosllavin socjaliste. Milionat e njerzve punuesa ne Vendin t'one po i realizojna sot nen flamurin e lavdishem te Partis, s'one gjurmat ma fisnike te shokeve t'one te rame. Dhe me çdo tulle, me çdo cope celiku, me çdo te mshueme te kazmes, me çdo fitore ne luften per socjalizem, komunistat dhe te gjithe njerzit punuesa te Jugosllavis e zgjedhin dita dites shokun Tito, nen udheheqjen e te cilit jane shkrue faqet ma te lavdishme te historis s'Atdheut t'one.

Fronti populluer i rrethit te Vuçiternes para akcioneve te randesishme

Organizatat e Frontit te rrethit te Vuçiternes gjate muejit qershuer kane ba luften e ashper per perballimin e detyrimeve te veta. Para organizatave jane parashtrue detyrat e randesishme: grumbullimi i leshit, kontraktimi i drithnave, dergimi i fuqis puntore ne minierat t'ona, ndertimi i shtepijave kooperativiste, mandej akcioni i regjistrimit te Huas popullore dhe problemet e perditshme: ndihma e te vorfenve ne pune, ndihma pronave shtetnore buxhesore ne punimin e tokes, rregullimi i rrugeve te katundeve, puna kulturo-arsimore etj.

Ne pikpamjen e kontraktimit te drithnave te bardha, organizatat e Frontit kane mbajte nji numer te madh konferencash, ne te cilat u asht shpjegue katundarve rregullorja mbi grumbullimin e drithnave dhe jane theksue te gjitha parimet e kontraktimit. Ne rreth, plani i kontraktimit asht realizue per 73,6 per qind, gja qe do te thote se agjitacjoni ne ket drejtim duhet te zazhdohet. Lufta kundra elementave shpekulanta ne ket rreth asht shum e ashper, sepse ata vazhdimisht perhapin rrena se kontraktimi i drithnave nuk do te merret parasyshe ne rakimin e tepricave. Elementat e tille sabotojne kontraktimin, sepse shum katundare te cilet ne vjetin e kaluem kane dhane 7 deri 8.000 kilogram teprica nuk kane kontraktue ma teper se 2 deri 3.000 kilogram, gja qe don me thane se ata perpiqen me e mposhte rregulloren.

Elementat spekullues te rrethit te Vuçiternes po rezistojne edhe po e sabotojne Huan popullore. Elementat e tille, per shembull ne katundin Gojbulj, Priluzhje dhe Novo Selle, kane fole haptazi kundra Huas popullore. Katundaret e pasun deri tash kane regjistrue ma pak Hua popullore, ne krahasim me katundaret e vorfen dhe te mesem. Kundra ketyne elementave Fronti populluer duhet te baje luft edhe ma t'ashper.

Katundet ma te mira ne regjistrimin e Huas popullore jane Smrekovnica, ku qysh diten e pare jane regjistrue 450.000 dinare, Shrovna me 199.000, Pasoma me 242.000 dhe Nedakovc me 189.000 dinare. Pasoma dhe Shrovna jane katundet ma pasur ne ket rreth.

Fronti populluer i ka ndihmue pronat shtetnore buxhesore gjate muejit qershuer me 2.000 ore pune, e ne mihjen e misrit jane dhane ma se 6.700 ore pune vullnetare. Fronti ka meremetue 12 kilometra rruge, ku kane punue 130 frontista dhe 90 pende qe per disa dite.

Fronti punon edhe ne ndertimin e shtepijave kooperativiste. Deri me 31 korrik do te jete gadi plotesisht shtepija kooperativiste ne Nedakovce. Ne ndertimin e shtepijave kooperativiste, gjate qershorit, kane punue ma se 6.400 frontista dhe 407 pend qe, te cilet kane dhane ma se 30.000 ore pune ne qerre dhe ma se 3.700 ne kafshe bartese.

NE NDERE TE KONGRESIT TE PESTE TE PKJ

Rinija popullore e rrethit te Prishtines u shpalle gara te gjitha organizatave te rinis ne Krahine

Sekretarjati i Keshillit te rrethit te Rinis popullore ne Prishtine ne marreveshtje me Kuvendin Krahinuer te Rinis popullore ka vendose qe per ndere te Kongresit te Peste te PKJ t'i thije ne gara te gjitha organizatat e rretheve dhe te qyteteve te Rinis popullore ne Krahine mbi pikat qe vijojne:

Kush ka me formue ma shum shoqni gjimnastikore dhe te regjistroje ma shum antar ne to, te ndertoje objekte fiskulturale, te perfshije ma shum te rij ne sportin, simbas programit mbi punen ideo-politike ndermjet rinis, cili aktiv i ilenarmdafiesive ka me ba dhane ma shum ndihme aktivave ne teren, organizata e kujt do te perfshije ma shum te rij ne pune, nga cila organizate do te marrin pjese ma shum te rij ne regjistrimin e Hinas popullore dhe kush do te regjistroje shuma ma te medha, cila organizate ka me dergue ma shum te rij n'akcjonet e punes, me dhane ma shum dite pune ne ndertimin e shtepijave kooperativiste dhe t'arrije efektin ma te madh te punes, te dergoje ma shum te rij n'objektet ndertimore dhe ne sipermarrjet industrijale, kush ka me dhane ma shum dite pune ne punimin e tokave t'atyne te rijve te cilet kane shkue n'akcjone.

Kjo gare fillon me 1 e vazhdon deri me 21 korrik, e Kuvendi Krahinuer ka me vendose se cila organizate ka me dale fituese ne ket gare.

Ne rrethin e Prishtines shtepijat kooperative po ndertohen me hov te madh

Akcjoni i ndertimit te shtepijave kooperativiste ne rrethin e Prishtines po zhvillohet ne shej te luftes per plotesimin e obligimeve te marruna per ndere te Kongresit te Peste te PKJ. Deri tash ndertimi me gure asht ba 100 per qind, e me tulla 51,2 per qind gja qe do te thote se punet e pergjitheshme ndertimore jane krye per 79 per qind. Disa vend ndertime kane sigurue landen e drunit nga burimet lokale, ndersa shumica landen do t'a marrin simbas ndamjes me plan. Me gjithe se ne kot rreth ka nji numer mjaft te madh te fuqis profesjonale punuese, kualiteti i punve asht i kenaqeshem. Ne mbare rrethin deri tash jane mbledhe 2.800.000 dinare per ndertimin e shtepijave kooperativiste.

Ne ket akcjon ma mire punohet n'Obiliq dhe Komoran. N'Obiliq punet ndertimore jane tue perfundue, e se shpejti do te kryhen edhe ne Komoran.

Tash per tash ma se dobti qendron puna ne Besinje, Llukare, dhe Zaplje Selle, ku mungon organizimi gadi krejtesisht, sepse ka dite kur ka teper fuqi puntore, e nder dite tjera te mungojne fare. Te gjitha punet ne keto katunde i kryejne disa udheheqsa te frontit, ndersa kryesija e ndertimit nuk ndihet aspak si nji trup i veçant udheheqes.

Ne fabriken „Zveçan" antaret e Partis korr in suksese te dukshme ne pune bashk me shoket tjere

Antaret e Partis te fabrikes «Zveçan» kane organizue brigaden prej 32 antarve, te cilet do te punojne jasht orarit te punes ne minjeren «Stari Trg». Ata ne shembullin e dukshem do te tregojne se si mund te shtohet prodhukcjoni me anen e formave te reja te punes dhe si duhet me organizue neper brigada punen politike-kulturale. Antaret i kane thirre dhe pranojne ne radhet e veta edhe ata qe nuk jane antare te Partis. Ne ditet e para te punes brigada ka tregue rezultate shum te mira.

Nga puna kulturalo-arsimore ne minjeren „Golesh"

Ne kolektivin punues te minjeres kane mesue shkrim e kendim 50 puntore analfabete e per se shpejti do te perfundohet kursi i tyne. Numri i parapa-guesve per shtyp asht shtue ne tre muejt e fundit per 47 per qind. Ka fillue nga puna salla e leximit te deges sindikale, e grupi diletant ka dhane çfaqje ne Shtimlje, Suvi Doll, Lipjan dhe Sedllar. Prej kursit te kultures se pergjithshme ne Shtimlje, i cili ka vazhdue 15 dite, kane kalue 22 puntore.

Ndeshje shahu

Ne Prishtine asht mbajte ndeshje miqsore e shahut ndermjet ekipave te shahut te Prishtines dhe te Pejes. Asht luejte me 8 tabela, nga nji parti. Rezultati i kesaj ndeshjeje asht 4 1/2 kundrejt 1 1/2 per favor te Prishtines. Partite i kane fitue per Prishtinen Dragan Vojoviq, Raketa Vulevuj, Vojo Dimitrijeviq, dhe Milo Kastratoviq, e per Pejen Rade Kastratoviq. Partija ndermjet Milladin Jovanoviqit dhe Dushan Karagjiqit asht remizue. Spektatoret qe ishin prezent, i kane ndjeke te gjitha partite me interesim te gjalle.

Nga inaugurimi i hekurudhes Prishtine — Kurshumli

(Vijon nga faqja e pare)

se sa popullin t'one, se sa udheheqesin dhe mesuesin t'one shokun Tito.

Anmiqet e ndryshem kane fillue me i zgjate veshet. Ata tash tregohen gjoja ma miq te Bashkimit Sovjetik. Kesi anmiqesh ka jasht, por ka edhe mbrenda ne Vendin t'one, keta kane gabue keq, se po na jemi ata te vjetit 1941. Te gjitha keto akuza do te humbin si fluska e sapunit dhe e verteta do te dali lakuriq ne shesh. Cashtja e jone asht e drejte. Na do te fitojme. Atyne qe jane tue e fole te pavertelen, u themi: nuk asht e vertete. Ne me veprat t'ona do te tregojme se Partija e jone Komuniste asht ajo qe qendron ne principet e marksizem—lenjinizmit. Detyra e jone asht qe t'i hedhim poshte shpifjet tue punue ma teper se deri tash.

Ata te byros Informative, tue na fole per kryengritjen, thone se ne Vendin t'one dhe ne Partin t'one ka fuqi te shendosha. Asht e vertete. Kemi ka mjaft fuqi te shendosha, e ma te shendoshat-ata ma te miret, njerzit ma te mire e ma revolucjonare jane ne Komitetin Qendruer te Partis Komuniste te Jugosllavis-rreth shokut Tito. Prandaj te gjithe ata qe perpiqen me fute çregullim n'aparatin t'one shtetnuer, dhe ekonomik duhet te shkelen. („ashtu asht").

Ne Kosmet jetojne shqiptar, serb, e malazez. Ketyne u kujtohet e kaluemja e idhet dhe e ruejne si gja te shenjte ate qe u asht ma e dashtunbashkimin ne mes te popujve t'one. Mos harroni te kaluemen, rueni vllaznimin e bashkimin. Ndiqnje rrugen ne te cilen ju ka pri Tito! (Brohoritje: Partis heroike Komuniste te Jugosllavis, Komitetit Qendruer, shokut Tito, vllaznimit dhe bashkimit te popujve t'one). Ti perforcojme rradhet t'ona edhe ma forte ne Frontin Popullor, rreth Partis Komuniste te Jugosllavis, rreth Komitetit Qendruer, rreth shokut t'one Tito. (I gjithe populli brohorite njizanit: do t'i forcojme.)

Mandej e muer fjalen ministri i minjerave te Republikes Popullore te Serbis, shoku Mehmet Hoxha. Mbassi vueni ne dukje se kurfare çpifjesh, nga çdo ane qofshin, nuk do t'a lekundin asnji qytetar te ndershem nga bindja se politika e Komitetit t'one Qendruer dhe shokut Tito asht e drejte, shoku Mehmet Hoxha vueni ne dukje fyemjet e randa qe u jane ba popujve t'one nga disa prej udheheqesash te Shqipnis. Ai ne mes te tjerash, tha: si gjate luftes Nacionalçlirimtare ashtu edhe mbas, me gjithe mungesat e mdhaja, kemi ba çmos me ia dhane ndihmen popullit vlla te Shqipnis. Per rindertimin dhe per ndertimin e Republikes Popullore te Shqipnis na kemi dhane njerze teknike, materjal, sasina kolosale drithi dhe afer 3 miljarde dinare ne vjet nga buxheti i jone, por udheheqesat e Shqipnis e kane harrue shpejt ket ndihme t'one vllaznore. Ata i kane shkele fotografin e shokut Tito, i kane ndalue gazetat dhe librat t'ona, i kane perzane teknikat qe i kemi dergue simbas kerkeses se tyne, kane hjeke dore nga traktatet, me nji fjale kane ba nji veper te shemtuet.

Por me gjithe keto popujt e Jugosllavis do t'ushqejne edhe tash e mbas dashni vllaznore ndaj popullit vlla te Shqipnis. E ata qe i kane shkaktue dhe kane urdhnue me u ba keso veprash çnjerzore per se shpejti do te mbesin me marre para popujve te Jugosllavis dhe para popullit te Shqipnis.

Mbas mitingut turma e pranishme e popullit i dergoi Komitetit Qendruer te PKJ nji telegram pershendetes.

BRANKO DRASHKOVIQ

Hero'i popullit - Sava Kovaçeviq

Me të jam takur disa here. — Ditet e takimit me të jane dite kremtje te ndritshme e te paharrueshme ne jeten t'ime. Me e kujtue sot Sava Kovaçeviqin — Mizuren, — e ket e dijne edhe te gjithe udheheqsat e bashkepuntoret e tij, edhe ata te cilve u ka qene komandant-te gjithe se ba shku—don me thane me ndie rreth vehtes dhe ne vehte ate fryme terheqse fitoresh te pa-arritshme qe perplotsojne largesin e mrekullueshme prej dashunis ndaj njeriut deri ne respektin para madhnis se tij.

Sepse te paket jane ata qe ma fort se ky t'a kene ba hapin vigan prej katundarit te thjeshte, njerit te popullit, deri të heroj i popullit, njeri prej atyne, me te cilet lidhet kjo kohe e jona e fitoreve dhe e namit.

Dhe nuk mund te thuhet se pjella e kujt asht — e Partis se vet, e epokes se te parve ase e asaje fuqije te madhnueshme qe i thone popull, ase te trijave se bashku... Ne personalitetin e tij, jane bashkue te gjitha, prej tinguilit te kumbueshem te lahutes, bungeshijes burrnore dhe dashunis se flaket per njerinn, deri ne garin tmerrshem t'usheper te rrufes.

I ketille ka qene komandant Sava.

Kah fundi i veres se vjetit 1930 — zbulimi e shkatrroi organizaten e Par, tis si nji stuhi e tmerrshme qe thane fusha e male. Me kalue atehere neper Malin e Zi te dashtun, per nji komunist, per çdo kend, zemren e te cilit e kane thirre mjerimet e popullit, asht njisoj si me kalue neper nji gremaje ne te plekun, kallaj e plote te e cilles i çfarosi-brezimi i papushueshem.

Ndonji fill, por, jo edhe nji dorez kallzish, i ndame ne shkretine te gjane e te pafund, ka mbete drejt ne kambe me e ruejte krenarin dhe namin e pa-arritshem t'atyne qe i ka perfshi stuhija, per te qene shtylle e re e besimit dhe perpjekjeve popullore.

Mbassi me ane te „lidhjes" s'ime mora udhezimet se „çka me ba", shkova te Sava, Jovani dhe Pavle Kovaçeviqi ne qarkun e Nikshiqit. I gjeta ne Bjella Gora, ku ishin mshefe perkohsisht nga gjurmimet dhe ndjekjet e papreme. Sava ishte i pezmatuem ma teper se dy te tjeret, si ujku ne ogem: nuk mund te duronte bile as ndamjen sado te shkurte prej popullit dhe dhimbjen per shoket e burgosun, qe vuejne. Tue me dhane informata dhe udhezime te hollsishme se si te filloj riaktivizimin e organizates me njerzit ma t'afermt te Partis, me paraqiti edhe kete kerkese ma urgjente:

— Menjihere na hedhni ne ndonji teren te ri jashta Malit te Zi, ku do t'ia fillojme punes dhe jetes ilegale... mos lejoni te na shkoje asnji dite kot! Duhet me dijte se çka do te bajshin tash ata qe jane nen kthetrat e Kosmajcit sikur te mujshin me u lirue; duhet t'a vazhdojme urrejtjen qe kane ata kundrejt anmikut! Te tala shokve dhe asnji minut mos e hjerr kot.

Heren e dyte jam takue me te para votimeve te Stojadinoviqit, me 1938. E gjeta ne burgun e prefekturas se Nikshiqit. Çka t'u thom per luftarin e burgosun te popullit, e bash ne kete dite kur ai duhej t'ishte ne popull. Asht nji soj si me fole per tigrin e ndryme ne hekura. Shetiste i pezmatuem mbrenda mureve te qelules se tij, shkrepte me dhambe dhe, pa u lodhe mendonte porosina kurajuese me ane te cilave i porositte katundaret e vet qe ne votime t'in apin grusht anmiqve.

Heren e trete e takova ne ditet e kryengritjes popullore. E me e takne Saven ne kryengritjen e armatosun donte me thane me e takue komandantin e popullit, te stolisun me shkelqimin e forte te namit, komandantin, te cilin e bajne ne krah fuqija popullore stihike dhe besimi i patundshem ne Partin... burimi i pashterrshem i fitoreve t'ona.

—Si asht situata ne sektorin e Krivoshijas?-pyet luftari luftarin!

—T'onet jane shum ma te paket ne numer, pa arme te randa, pa pushko-mitroloza, por sigurisht do te fitojne!

— Kah e din ti, shok, se do te fitojne?

—Po a asht Sava me ta apo jo?

—Ky besim i pathyeshem i te gjithe shokve te tij, edhe i udheheqsave dhe i luftarve-se fitorja asht atje ku asht Sava, shpjegon edhe shum gjeste te tija, edhe heroizmin e ushtris se tij. Pa ket, Sava, as qe mund te kuptohej e aq ma pak te çmohej.

Ne rrugen Bileqe—Nikshiq nji kolone e tane e murrme alpinesh italjane Nji, dy... disa qinda helmeta me pendla pu'ash. Kolonelli, tankat, topi e intendantura. Per njeriun e luhatshem-fuqi e madhe dhe vang- i mire per me u leshue rrugen.

Po per Saven...

Jo, se asht ba prite per qinda vetesh, vetem sepse asiç i vendosun qe perdhi, te te gjalle dhe prane tij, bishat fashiste mos te shke'in te qeta neper rrugat e atdheut te tij.

—Kur t'i tregojsh popullit se ushtari i kuq, para Minskut e Smolenskut verselet mbi "tigrat" gjermane prej çeliku, versulu edhe ti shok ketu para Bileqes mbi tankzat italjane!... u flitte Sava disa partizanve me te cilet e vrente, nga prita, kolonen e anmikut.

Prej pese-gjashte gryka pushkesh prita shkambore qitte zjarr te gjalle, shoqnue me bumbullimin e rrufes se komandes se Saves, sepse Sava i komandon dhetshet jo te plote, e anmiku e ndien tmerrin e sulmit te nji garnizoni te plote...

Mbaiandaj hurra! Mishi i gjalle i versulet çeliku,-njerzit hidhet mbi tanksat... plasja e bombave, perleshje vdekjeje dhe heshtja...

Atje ku asht Sava, me doemos do te jete edhe fitorja.

Alpinet e shpartalluem-te marrun mendesh prej hikjes nga sulmi i tmerrshem,-nuk kane gajle as per te vdekunit as per te plagosunit, as per kolonelin e zanun rob, as per tanksat e topat e tyne... Zune topin e pare, te cilin, prej dashunije e thirrem "Nenad"-shprese e madhe e popullit duerthate dhe luftareve te tij-artileri e kryengritjes!

Ne Verbnice, vend ku bashkohen kufijt e Bosnes e Hercegovines dhe Malit te Zi, ne llogore asht vendosa taborri i shkathte i brigades se V te Malazeze te Saves. Mbas kishim lane nji vjet nami dhe dashunije, mbas nesh kishim lane pikllimin e popullit qe e lejshim, mbas nesh potera e divizjoneve italjane dhe trathtarve çetnike, ne ne besimi i pathyeshem ne fitoren, e para nesh gjermanet, ustashet, dhe Bosnja e panjoftun...

Me e ruejte spitalin, te gjithe te plagosunit dhe te gjithe te smundit prej tifos n'ushtrin t'one, me u kendelle me nji pushim te shkurte dhe me u-nise mbas forcave kryesore si mbraparoje,-ky ishte urdhni i Titos, mloshta ma i veshtiri, por edhe ma i ndershmi i ketyne diteve... Kete e vertetoi mbas nji muaji, shperthimi i brigades se peste neper hallkat e zjarrta te gjermanve, partizanve e çetnikeve, neper betejat e pa-prema prej Zelengores ne Prozor, me vigjet e shokve te smunde, te plagosun rande ne duer, femije e pleq te pa shtepi me ne. Keshtu e futi Sava brigaden e vet ne pagezimin e pare luftarak.

Çdo pikllim asht i rande, por s'ka pikllim ma te rande se pikllimi i komandantit per luftaret e humbun. Ket pikllim mbi pikllime e kemi lexue per here te pare ne fetyren e Saves, ne katundin e vogel Grandiqi, afer Verbnices. Per çdo dite na pergjerojshin „Savojat". Nji prej tyne hodhi bomben ne mjedis te luftarve te kompanis se pare te batalionit te pare, qe ishin grumbullue ne nji mbledhje — ra bomba e kobshme, e cila qilloi 19 shoke. — Dymbdhjete prej tyne mbeten ne vend!

Pikllim asht fjala, pikllim asht edhe dhimbja e skyferit per zogun e humbun, pikllim asht edhe dhimbja e prindve per djalin e vetem te rane ne lufte por pikllim i vertete asht vetem ai qe, si tronditje e tmerrshme ngrin buzeqeshjen prore te kthjellte, prore burrnore, kur e lajmuen per vrasjen e shokve ne Grandiqi. Nji e dridhme e pershkoi mustaqen e zi e te djersitun, nji shtangim nofullash, shtangim aq i njoftun nofullash te Saves dhe nji krisje dhambesh, si gjam'e rrufes. Ushtoi kerkesa e tij... „Kalin"! — dhe Sava vrapoi ne shpine te kalit, i metun pa mend nga dhimbja, drejt Grandiqit.

Dhe çdo dite keshtu — Sava pror'i njajte, pror'i ri. Çdo dite shok me zemer, prind me dashuni e kujdes mbi ne, komandant me besimin e triumfuesit dhe mesues me qortim, prej te cilit ngrohet gjoksi.

Per dite Sava — te gjitha vyrtytet e ushtris s'one ne nji njeri. Sava — jo njeri çfaredo, por per epopen!...

E Sutjeska dhe vrasja e tij?...... Ku asht Sava, aty edhe fitorja! vrasja asht garant fitoreje: kete e vertetoi Sava ne Sutjeska, sepse — athua po e teprojme —po te mos kish qene Sava, do te na kishin mbete mangut, disi te gjymte edhe Sava edhe Sutjeska...

Thyemja e sernishtave, me njihere mbas korrjes asht nji nder masat ma te randesishme per shtimin e produktivitetit

Thyemja e sernishtave, menjihere mbas korrjes, asht nji nder masat ma te randesishme agroteknike per shtimin e produktivitetit ne bujqesi. Kjo masë e re e provueme mbas luftës, ka dhane perfundime shum te mira. Nga zbatimi i drejte dhe me kohe i kesaj mase agroteknike mvaren shum suksesat e mavonshme te te gjitha punimeve bujqesore tue fillue nga plehnimi e deri te rritja e bimve.

Thyemja e sernishtave asht ne rend te pare, mjeti ma i pershtatshem per zhdukjen e barit te keq. Fara e ketij bari derdhet shum me rastin e korrjes; kjo e ruen cilsin e te bimunit dhe me rastin e mbjelljeve te vjeshtes hyne ne dhe keshtu qe ne pranvere bin dhe fillon e rritet bashke me kulturat e mbjellura. Çdo bujk e din se sa dam te madh u shkakton bari i keq drithnave te bardhe. Me thyemjen (lavrimin) e sernishtave me njihere mbas korrjes fara e ketij bari hyn ne toke, detyrohet me bi shpejte dhe me rastin e mbjelljes se vjeshtes zhduket fare lehte e pa tamen. Me anen e kesaj mase agroteknike, d. m. th. me thyemjen e sernishtave zhduken edhe kepurdhat e rrajzat e ndryshme, te cilat mund t'u sjellin bimve dame mjaft te mdhaja.

Perveç kesaj thyemja e sernishtave ka randesi te madhe edhe persa i perket mbajtjes se strukturës se mire te tokes dhe ruejtjes se lagshines, n'anen tjeter e lehteson depertimin e ajrit e te shijnave gjate veres dhe krijon parakushtet per lavrimin e thelle te vjeshtes.

Nga praktika e deritashme asht konstatue se me thyemjen e sernishtave me nji here mbas korrjes, shtohet prodhimi 2—3 cent per nji hektar. Po t'a llogaritim kete per mbare Krahinen t'one do te shofim se do t'a shtojme produktivitetin me shuma vagona.

Suksesi i plote i kesaj mase te randesishme sigurohet vetem atehere kur thyemja e sernishtave te bahet ne ditet e para mbas korrjes dhe te mos bahet ma e thelle se 5—6 centimetra.

Ne rast te kundert, jo vetem qe nuk do te kemi kurrfare dobije, por mund te kemi edhe dame, mbassi thyemja e vonshme e sernishtave shkakton thamjen e tepert te arave, kurse thyemja nen 6 centimetra, ne kete kohe perveç qe shkakton thamjen e tepert, por e pengon edhe bimjen e fares se barit te keq, keshtu qe zhdukja e ketij nuk bahet e sigurt. Mjeti ma i mire per thyemjen e sernishtave jane maqinat speciale t'ushtruemit „lunjiroç", te cilat gjinden prane stacjoneve te maqinave e te traktorave, mirpo mund te bahet edhe me te gjitha mjetet e tjera te korres.

Tue marre parasyshe randesin e madhe te kesaj mase te te agroteknike duhet t'organizohet mire puna per zbatimin e saje dhe te bahet lufte e vazhdueshme per suksesin e plote. Bile lufta per realizimin e planit te thyemjes se sernishtave duhet te jete edhe ma e gjalle. Prandaj per zbatimin e kesaj mase agroteknike duhet t'angazhohen perveç organeve te pushtetit popullor, stacjonet dhe teknikët bujqesore dhe kooperativat e rretheve. Rol me randesi duhet te luejne edhe organizatat e Frontit te cilat duhet t'ua shjarojne bujqve randesin dhe te mirat e kesaj mase, n'anen tjeter te perpiqen per mbajtjen e drejte te fuqis puntore dhe te kafsheve te terres.

Çdo bujk duhet t'a dije se kjo mase asht direkt n'interesin e tij dhe n'interesin e komunitetit prandaj duhet te perpiqet qe t'i lavrojne te gjitha sernishtat e veta sepse kjo asht nji mase e sigurte dhe e provueme si kundra thatesis ashtu edhe kundra barit te keq e semundjeve te ndryshme te kulturave te mbjellura.

DISA SHENIME MBI KURSIMIN E DERDHJEN E MATERJALIT NE SIPERMARRJEN „GRAÇANICA"

Sot ne mbare vendin t'one njerzit e punes po luftojne me sa fuqi kane per t'a zbritë çmimin e plote te kushtimit. Ne planet e gjerave per nderë te Kongresit te Peste P.K.J. asht edhe lufta per zbritjen e çmimit te plote te kushtimit. Dy elementet kryesore per realizimin e ketij qellimit jane edhe lufta per kursim dhe mos derdhja e kote e materjalit.

Drejtorija e sipermarrjes ndertimore „Graçanica" se bashku me te gjithe puntoret koshjenta po lufton me sa fuqi ka per realizimin e ketij qellimi. Nji nder masat ma te suksesshme qe ka marre kjo sipermarrje per kursimin e materjalit asht pergendrimi i latimit te landes ndertimore dhe i ndryshjes se hekurit te betonit prane depove, gja qe ka ndalue derdhjen e sasinave te medhaja te materjalit. Kjo menyre asht mire te praktikohet nga çdo sipermarrje e keille ne krahinen t'one. Kjo ka ba te mundeshme qe te gjinden lehte te gjitha pjeset e duhuna te materjalit te latuem.

Neper te gjitha sendpunimet po praktikohet mbledhja e tepricave te materjalit. Dega sindikale ne bashkepunim me Drejtorin e sipermarrjes vazhdimisht lufton me ane te konferencave, udhezimeve e keshillimeve per eliminimin e te mbetave qe synohen ne pune. Disa nga nga keto te mbeta qe influencojne damshem ne kursim po i permendim ketu:

Disa puntore vijne ne pune pikrisht n'ora 6, kur duhet te filloje puna, e disa edhe ma vone. Deri sa te gjithe puntoret te thirren emen per emen, kalojne edhe 15 minuta. Kjo mungese shkakton vonesa ne fillimin e punes. Kjo mosdisipline i shkakton dame te mdhaja procesit te punes. Prandaj duhet te merren masa rigoroze per eliminimin e saje.

Mandej, karrocashijt nuk kujdesen aspak per ruejtjen e materjalit e sidomos te tulles e gelqeres me rastin e bajtjes. Keta kane mesue edhe nji gja: kur i qorton sipermarrja per moskujdesin e tyne, me njihere lane detyren dhe shikojne dicka tjeter me punue.

Ngjajne raste qe ndonji puntor ia kerset bisedes gjase e gjate dhe deri sa te mbarije biseda, puna i mbetet mbrapa.

Disa puntore, per t'a plotesue normen e kuantitetit te punes, nuk i vene kujdes materjalit: ka nga p. sh. ne ndertesen e Sigurimit social qe nji puntor t'i hjedhi pameshirshem skelat e perdoruna te cilat bahen cope e grimë. Keshtu sabotohet çfrytezimi maksimal i materjalit.

Ramazani ka shkaktue nji pengese te madhe ne pune. Disa puntore per kete arsye nuk dalin per dite ne pune.

Menyra e re e muratimit perdoret shum pak. Kjo rrjedhe nga se shumica e shjshkeve asht gadi krejt e muratueme. Çeshtja e pregatitjes se punes asht permirsue shum dhe tash nuk paraqet pengese ne pune. Organizimi te punes duhet me i kushtue kujdes ma te madh. Kryepuntoret nuk perpiqen sa duhet per sistematizimin e punes. Materjali i shte-pijave te ucmueme nuk çfrytezohet ne maksimum.

Ne lidhje me punet ndertimore ne Prishtine duhet theksue edhe nji gja: Fronti popullor i qytetit dhe organizatat sindikale nuk e kane organizue si duhet çfrytezimin e fuqis vullnetare puntore. Ka nga qe shum çeta puntore te bjerrin kohe tue pritë mjetet e punes, ase tue pritë se ku do te vazhojne me punue. Tash, me marrjen e obligimeve individuale kjo çeshtje mund te rregullohet ma mire, por Fronti duhet t'a sistematizoje punen e jo me mbete si deri tash. Sot nevojitet ma se teperni fuqija puntore.

Per likuidimin e ketyne leshimeve duhet ba lufte e pa preme, sepse me likuidimin e tyne do t' arrihet kursim i madh materjali, do te çfrytezohet ma mire koha e punes dhe keshtu do te zbritet çmimi i plote i kushtimit me nji perqindje te konsiderueshme.

Keto dite ka hy ne fuqi Dekret-ligji i ri mbi pagimin e puntoreve i cili asht i lidhun ngushte me normat ne pune. Nga ana tjeter per puntoret e zellshem ne qofte se e kapercejne normen jane parapa shperblime, e ata qe per arsyena disiplinore nuk i kryejne normat e tyne edhe do te denohen materjalisht. Pra, ekzistojne te gjitha kushtet qe çdo puntuer te fitoje simbas punes qe ban.

E tane pona qendron ke puntori: si te punoje, ashtu do te fitoje, sa te perpiqet aq do te preferohet. Prandaj as nji puntuer nuk duhet te kursehet per pune, sepse sa ma mire e ma shum te punojne aq ma teper e shpejteson ndertimin e socializmit, aq ma mire i permireson kushtet e jeteses.

Per permrisimin e shendetit te popullit t'one

Akcjoni i luftimit te malarjes ne Krahinen t' one

Drejtorati i Shendetsis ka ndermarre edhe ne vjetin e kaluem qe te luftohet me plan malarja ne Krahinen t'one. Efekti i ketij akcjoni ka qene bukur i dukshem nder vendet ku jane marre masat e zhdukjes se mushkajave dhe çerdheve te tyne, gja qe ka shkaktue mos-persritje te malarjes nder ato vise.

Tue pase nji eksperienca ma te gjalle, ne ket vit akcjoni filloi me 1 Maj ma sistematikisht, i udhehequn prej mjekevet te Drejtoratit te Shendetsis dhe te rretheve e qyteteve. Ndihmen ma te madhe ne kete akcjon e kane dhane organizatat masovike antifashiste dhe Armata Jugosllave. Deri tash jane dergjue me barnat perkatese te luftimit te mushkajave: Ferizaj, Gilan, Mitrovica, Gjakova, Suharekia, dhe ma se njiqet katunde te rretheve te ndryshme. Nder keto katunde ma se pari asht ndermarre ky akcjon nder ato ku jane dergue femijt e shkollave per verim, si b. i. Rugova, Sterkel, Vrelli, Kosovrast etj.

Se shpejti do te perfundoje akcjoni dhe ne Peje, Vuçiterne e nder shum katunde te Krahines.

Gjate gjith ketij akcjoni jane dallue ne pune organizatat e Rinis, te Frontit, e diku diku edhe ato sindikale. Neperemjet kesaj pune po zhduken te njit t'one, te cilve dite per dite po u bahen mesim metodat e luftimit te malarjes.

Se shpejti do te fillaroje nji aeroplan i cili ka me i sterpike moçalet e mdha n'afersinat e Drinit te Bardhe, ku mushkajat i kane çerdhet e tyne ma te dendura. Perveç sterpikjes do te kontrollohen rregullisht moçalet me nji perferi prej 1 km, tue e evitue shtimin e mushkajave „anofeleks" nder 99 vende te ndryshme.

Simbas planit, akcjoni zgjanohet edhe nder vende tjera ku asht perhape malarja. Tue qene se katundaret e kane pa dobin e madhe qe ka sjelle ky akcjon ne zhdukjen e mushkajave e te çerdheve te tyne, dhe n'anen tjeter, akcjoni i plehnimit te banesave te njerzve dhe te shtallave etj. me plehun „Didit" etj; dita per dite kerkojne nga Drejtorati qe te nder merret per zhdukjen e minave etj. Tash per tash deshiri i te gjithve nuk mund te plotsohet, por vetem i atyne vendeve malarike ku po luftohet malarja. Afer neperemjet te ketije akcjoni luftohen te gjitha, keshtu qe edhe lakshet peshtojne prej buktave te dameshme.

Metodat e mjekve te Krahines s'one ne te luftimin e malarjes jane tue u zbatue ne mbare vijat malarike te Jugosllavis.

Deri tash asht perdore gjithnji materjali i UNRA-s por se shpejti nga fabrika e posaçme qe po ndertohet ne Vendit t'one, do te prodhohen barnat "Pepein" ne pluhun e lang qe e zavendesojne ma se miri pluhnin „didit".

Paralelisht me te gjitha keto jane po bahen prova per mjekimin ma te shpejte me barin e ri te malarjes: „Paludrin, — i cili pamolet ne Vendin t'one, por ende nuk jane perdue t'one, por ende nuk jane perfundue te gjitha provat e nevojshme.

Per evitimin sistematik te mushkajave dhe paralelisht me sherimin e atyne qe e kane te vjeter malarjen, vjet per vjet po ndihet zhdukja e saje, e cila deri tash na ka damtue Vendin t'one ne miljarda dinare.

Neperemjet te gjitha ketyne akcjoneve po zhduken mundesinat e perhapjes se malarjes, tue e permiresue shendetin e popullit dhe tue e siguruе nji ardhmeni ma te lumtun per te gjithe.

Ne kete akcjon jane dallue per ndihmen ma te madhe, antaret e sindikates ne Peje, rinija popullore e Gilanit dhe çetat e Armates Jugosllave ne Prizren.

Nder mjeket kane kallaue interesim te madh ata te Pejes, te Gjakoves dhe ndihmes doktori Shukri Karadanoviq ne Mitrovice.

Nga situata nderkombetare

Marreveshtjet Bilaterale dhe kushtet e tyne disfatiste

Ne lidhje mbi t'ashtuquejtunen ndihme te perkohshme shteteve te jashtme, Shtetet e Bashkueme t'Amerikes kane futë edhe dispozitan qe te 16 shtetet — pjesmarrese ne planin Marshall — duhet te lidhin marreveshtje bilaterale me SH. B. A., me te cilen dispozite caktohen kushtet e ndihmes amerikane. Para pak ditesh u botuen tekstet e ketyne marreveshtjeve te cilat u nenshkruen me zore prej parlamenteve te 16 shteteve me 3 korrik. Te gjitha fletoret e shtypit te jashtem, bile dhe agjensinat borgjeze kane konstatue se marreveshtjet kane marre definitivisht formen e planit Marshall e dispozitat e tyne jane vetem nji dominim i plote ekonomik e politik i Shteteve te Bashkueme t'Amerikes, te cilin u a ka imponue gjenerali i Trumanit — Marshall — shteteve te planit te tij. Marreveshtja permban 26 klauzula, dhe çdo njena prej tyne asht shkelje brutale e sovranitetit kombetar dhe pamvarsis politike e ekonomike te shteteve te marshallizueme, jane disorganizem i plote i ekonomis se tyne i tregtis dhe financave si dhe kontroll apsolut i Volstritit mbi politiken e tyne te mbrendeshme e te jashtme. Qeverit e 16 shteteve, kundra interesave te popujve te tyne, kapitulluen definitivisht para ministrit te pare t'ekspansjonit dhe imperjalizmit amerikan.

Me gjithse Marshalli asht perpjeke me ia mshefe opinjonit publik teksin e marreveshtjes si gjarpni kombet me gjithse bashkepuntoret jane ba te mshefta, opinjoni publik i prenditi i hetoj kushtet disfatiste te ndihmes amerikane, e bile gazetat ma reakcjonare proamerikane ne prendim i kuvu kape ethet trivjeçare.

Qysh me 13 korrik Danimarka, e para mori guximin me kerkue ndryshime radikale ne tekstin e marreveshtjes, e me 15 qershuer agjensija britanike „Rajter", e cila e para me nji here se dispozitat e marreveshtjes jane vetem kangu lebodi te funtes dhe imperatoris britanike, me dembrim komunikoi se „shum dispozita jane te pa pranueshme". Po ne kete dite kjo agjensi me gjeje ne toke u asht lute 16 shteteve „qe te formojne frontin unik kundra dispozitave poshtnuese ne projektin amerikan te marreveshtjes, dhe t'a hjedhin poshte". Edhe imperjalistat ma te damkosun dhe luftetarve te flaket te strategjis antisovjetike te Trumanit ne kabinetin britanik gadi u ra te fiket kur ndigjuen se ç'fare kushtesh ditron Amerika. Nji prej tyne ka deklarue me 18 qershuer se „projekti i marreveshtjes asht dokument qe i imponohet shtetit te mundun per t'a nenshkrue", e organi i qarqeve t'investimit dhe te bankave ne Londer „Finenshell Tajms" ka shkrue ne faqen e pare: „kjo marreveshtje u a veshe shteteve europjane kemishen e mare te preme n'Amerike. Mangester gardjan i bjen borie se revoltit dhe bertete se „marreveshtja e autorizon SH. B. A. me kontrollue efektin mbi buxhetin britanik dhe me e marre sundimin mbi imperatorin", e fletorja „Nju Stejtsmen end najshen" konstaton me dhimbje se „marreveshtja e eliminon planin britanik t'eksportimit, nevojen themelore te rindertimit britanik. Prej Britanjes kerkohet me nenshkrue kushte te pamundeshme, me i pre preferencjalet imperjale ne pasunit e veta dhe me u a lejue amerikanve kontrollin e politikes britanike t'investimit ne koloni dhe dominjonet". Junajtet Pres ka pranue me 20 qershuer se SH. B. A. me kete marreveshtje dishrojne ma e pervehtesue kontrollin mbi funtet e sterlines.

Ne France, dispozitat e marreveshtjes kane qene nga teksti bile edhe kuislinget e njoftun ne qeverin gjindarjne — truste te Robert Shumanit. Shumani ka qene i detyruem qe ne seancen e qeveris t'i thirre gualajteret amerikane ne France — ambasadorin Keferi e Harimanin, — per t'i qetsue ministrat e pasjellshem qe jane çue kundra marreveshtjes. Francen e kane qillue rande sidomos dispozitat e marreveshtjes qe kerkojne devalvacjonin e frangut, qe Franca tua njofi Gjermanis, Japonis dhe vendeve tjera nen okupacjonin e Vashingtonit poziten e kombit ma te privilegjuem ne marredhanjet tregtare, qe kompanit amerikane te formojne ne France sipermarrjet e tyne per çfrytzimin e pasunise te vendit, qe Franca t'ia nenshtroje kontrollit amerikan prodhimin e çelikut, qymyrit, mjeteve te komunikacjonit, gjanave ushqimore dhe artikujve te tjere, dhe t'i ape Amerikes „artikujt e rralle p. sh. uranjumin, etj., per t'i plotsue rezervat luftarake amerikane.

Edhe ne shtetin ma servil te Marshallit n'Italin demo-jezuite kushtet e marreveshtjes kane shkaktue revolt te rrepte n'opinjonin publik. „Marreveshtja e ngarkon Italin dhe qeverin e saje me zbatue nji ndryshim t'alille te kursit te tregut, i cili do t'ua baje te mundeshme firmave amerikane me i siguruе landet e para italjane dhe te tane materjalin e duhun" — pohon fletorja reakcjonare ekonomike "Globo".

Ç'fare jane keto dispozita te marreveshtjeve bilaterale te cilat e kane sjelle te tane prendimin ne revolt kundra imperjalizmit amerikan? Thjesht, keto nuk jane kurrfare marreveshtje e barbarie, por kerkesa drastike t'imperjalistave amerikane te paraqituna gjakftoftesisht ne forme ultimatumi, dhe te drejtueme ne likuidimin e pamvarsis politiko-ekonomike te 16 shteteve. Keto drejtohen ne sundimin qind per qind te monopoleve amerikane mbi keto shtete. Simbas marreveshtjes te gjitha vendet e Planit Marshall detyrohen me e kryе devalvacjonin e monedhave te tyne kurdo qe t'a kerkojne Sh. B. A., me i kepute ta rifat dhe kufizimet doganore, e Anglija edhe preferencjalet imperjale, me i liferue Amerikes te tane materjalin dhe landet e para me randesi strategjike, me ia lejue Amerikes kontrollin mbi perdorimin e kredis dhe lirin e pakufijshme te levizjes se kontrolloreve amerikane ne teritoret e tyne, me e ndalue eksportimin e disa artikujve ne vendet e Europes lindore dhe Gjermanis, Japonis, Kores dhe koloniwe tjera amerikane t'ua njofin te drejtat e nacjonit ma te privilegjuem ekonomik. Sh. B. A. kerkojne me i caktue dhe kontrollue buxhetet e çdo shteti pjestar te Planit Marshall veç e veç, me formue sipermarrjet e veta ne teritoret e ketyne shteteve, kerkojne perzimjen ma brutale te Vashingtonit ne te gjitha deget ekonomike te shteteve te Planit marshall dhe vendosjen e amerikanve n'unjonin francez. Shkurt: Sh. B. A. kerkojne qe 16 shtetet te nenshtrojne vullnetarisht ne politiken e tyne ekonomike, valutare e tregtare t'ua nenshtrojne interesave te Sh. B. A.

Botim i Keshillit Krahinuer te Frontit popullor — Shtypshkroja Krahinore e Frontit Popullor Pajtimet ne fir tore i pranon: Administrata dhe ekspedicioni.